

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtaria Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike të paditëses “ A.”sh.p.k me seli në P. rr.”...” nr .. ,të cilin me autorizim e përfaqësoj avokati F. G. nga P., kundër të të paditurës ”T.”NNT me seli në P., të cilën me autorizim e përfaqësoj avokati N. Th. nga P., për pagesën e borxhit në shumën prej; 12.759,38 €, në seancën e mbajtur më dt.07.05.2015, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses dhe në mungesë të përfaqësueses të të paditurës,ndërsa me datë 21.05.2015 merr këtë:

A K T G J Y K I M

SHFUQIZOHET Aktvendimi i kësaj gjykate për lejimin e përmbarimit,E.nr. 580/13 i dt. 05.07.2013, ashtu që ky Aktvendim, në pjesën obliguese për borxhin kryesor,kamatën dhe shpenzimet, suprimohet në tërësi.

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “ A.”sh.p.k me seli në P. rr.”....” nr .. .

I.DETYROHET e paditura ”T.”NNT me seli në P. që paditëses “ A.”sh.p.k me seli në P. t’ia paguajë borxhin kryesor në shumë prej 12.760 € (dymbëdhjetmijë e shtatëqind e gjashtëdhjet euro), së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 3,5 %, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë ;27.06.2013, e deri në pagesën definitive të borxhit, të gjitha në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi,nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II.Refuzohetsi e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për shumën 58.34euro

Secila palë i bartë shpenzimet e procedurë kontestimore veq e veq.

A r s y e t i m

Kreditori “ A.” sh.p.k me seli në P., me datën 27.06.2013 ka ushtruar pranë kësaj Gjykate propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit autentik , kundër debitorit ”T.”NNT me seli në P. ,duke kërkuar që t’ia paguaj në emër të borxhit në shumë prej 12. 759,38 Euro, me kamatë ligjore 3.5 % nga data 27.06.2013 si datë e paraqitjes së propozimit për përmbarim deri në pagesën definitive të borxhit,të gjitha këto pas administrimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Kundër Aktvendimit të përmbarimit të kësaj Gjykate, E.nr. 580/13 i dt. 05.07.2013, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur kundërshtimin, duke e kontestuar aktvendimin për përmbarim në tërësi.

Mbi bazën e ushtrimit të kundërshtimit në kuptim të nenit 57.3 të Ligjit për procedurën për mbarimore (LPP), Aktvendimi për përmbarim është shfuqizuar në pjesën detyrimore, që ka të bëjë me borxhin kryesor dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe çështja konform Nenit 58.4 të Ligjit për procedurën përmbarimore (Ligji nr. 03/1-008) ka kaluar në procedurë kontestimore, në të cilën propozimi për përmbarim ka marrë cilësinë e padisë.

Lidhur me këtë çështje juridike Gjykata duke u bazuar në nenin 423 paragrafi 4 të LPK-së, mbajti seancën kryesore, në mungesë të të paditurit, pasi që i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt me çka u vërtetua nga fletëkthesa, e cila gjindet në shkresat e lëndës, por mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

Paditësi në seancën kryesore ka precizuar kërkespadin pas marrje së mendimit dhe konstatimit të ekspertit financiar në shumën e përgjithshme prej 12.818,34euro dhe në të njëjtën kohë i ka propozuar gjykatës që kjo shumë të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe se i padituri ka konfirmuar pranimin e borxhit në bazë të deklaratës së datës 07.01.2013 ku të njëjtën e ka nënshkruar dhe vulosur. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

I padituri në përgjigje në padi ka kundërshtuar padin dhe kërkespadin duke theksuar se nuk është bërë barazimi i shumës kontestuese .

Gjykata gjatë shyrimit kryesor të kësaj çështje ka administruar këto prova: fatura me nr.0317 e datës 24.12.2009, kartela e kominientit prej datës 01.01.2009 e deri me datë 31.12.2009 , libri i shitjes e datës 01.12.2009,31.12.2009,kërkesa për tërheqjen e propozimit për lejimin e përmbarimit e datë 09.01.2013,deklarata e paditurës e datës 07.01.2013,barazimi i faturave të vitit 2010,ekspertiza financiare nga eksperti R. B. e datës 16.02.2015.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me çmuarjen e të gjitha provave të prezentuara nga palët ndërgjyqëse është bazuar në dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën dhe Kontestimore të Kosovës.

Nga deklarata e datës 07.01.2013 gjykata gjeti se e paditura ka pohuar se i ka borxh të paditurës shumën prej 12.760 euro,për pranimin e mallërave ,ku të njëjtën e ka nënshkruar dhe vulosur, ashtu që edhe në bazë të nenit 368 paragrafi 2 të LMD-së e cila parasheh pohimin e borxhit,rezulton se e paditura i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e faturave , andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit.

Ndërsa sipas ekspertit financiar R. B. në mendimin dhe konstatimin e tij të dhën me datën 16.02.2015 nuk ka dhën do një konkludim përfundimtar të precizuar por ka theksuar se në bazë dokumentacioneve të cilat gjinden në shkresat e lëndës si dhe sipas deklaratës se paditurit e cila është valide del se e paditura i ka borxh shumë prej 12.760euro, mirpo eksperti ka theksuar se palët ndërgjyqëse mardhenjet e tyre afariste i kanë bërë me mirëbesim dhe se dokumentacionet nuk i plotëson standartet për tu konsideruar valide ,po ashtu ka cek se në procedimin e ekspertimit e paditura i ka kontesuar 8 kuponat ku në bazë tyre është bër shitblerja dhe për këtë qështje ka vlerësuar se e njëjta mundë të vlerësohet nga gjykata.

Ndërsa gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 319.1 të LPK,me të cilën dispozit në mënyr shprehimore thuhet se secila palë ka për detyrë që t'i provojë faktet mbi të cilat e bazon pretendimin e saj,në këtë rast e paditura nuk ka pprezentuar në seancë e as nuk ka paraqit ndonjë provë lidhur me pretendimet e tij,andaj gjykata duke u bazuar ne shkresat e lendes dhe at ne deklaratën e të paditurit me të cilën vërtetohej borxhi ndaj paditësit,e aprovoj pjesërisht kërkespadine e paditësit ,duke e aplikuar nenin 368 paragrafi 2 të LMD-së,që parasheh pohimin e borxhit.

Gjykata duke iu referuar nenit 8 pika 1 të LMD-së, të cilët parashohin se palët kontraktuese në marrëdhëniet detyrimore kontraktuese janë të obliguara t i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke, andaj në bazë të këtyre dispozitave gjykata ka vlerësuar se ekziston obligimi i të paditurës për pagesën e borxhit.E paditura, duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e faturave të pranuar dhe të pakontestuara, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit.

Sipas nenit 245 paragrafi 1 të LMD-së, kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos-përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura me mospagimin e faturave i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartëcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin në shumë e gjykuar.

Gjykata e refuzoi kërkespadin e paditësit për pjesën tjetër të saj gjegjësisht mbi shumë në vlerë prej 58.36euro , për arsye se kjo pjesë e borxhit nuk është përfshirë në deklaratën e pohimit të borxhit dhe nuk është konstatuar bindshëm me ekspërtizën financiare.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 382 pargarfi 1 të LMD-së, gjykata e detyroj të paditurën që t'ia paguaj paditësit, shumë e gjykuar së bashku me normën e kamatës, në lartësi prej 3,5%.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 463.2 të LPK-së, meqenëse i autorizuari i paditësi nuk i ka precizuar shpenzimet .

Prandaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi,duke u bazuar në nenin 245 të LMD-së,si dhe në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.C.nr.479/2013 me datë 21.05.2015

Gjyqtarja;
Franciska Zhitija-Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve,duke llogaritur nga dita e pranimet të të njëjtit,duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj gjykate.